



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 06/L -037

PËR METROLOGJI

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR METROLOGJI

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë ligj rregullohet sistemi i njësive matëse, etalonët për matje, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e para paketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbrojtjen e konsumatorëve dhe sigurisë së përgjithshme nga rezultatet e pasakta të matjeve.

2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me parimet dhe kriteret kryesore të Direktivës së BE-së 2014/32 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 26 shkurt 2014 për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare përkitazi me vënien në dispozicion të tregut të mjeteve matëse si dhe dokumentin D1:2012 të OIML-së.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen në organizimin e aktiviteteve metrologjike, përdorimin e njësive matëse ligjore dhe gjurmueshmërinë e etalonëve të matjes në Republikën e Kosovës, vendosjes në treg dhe përdorimin e mjeteve matëse ligjore, vlerësimin e

konformitetit të mjeteve matëse ligjore me kërkesat e përshkruara, produkteve të parapaketuara, vlefshmërinë e dokumenteve dhe shenjave të huaja të konformitetit, mbikëqyrjen metrologjike, si dhe çështje të tjera të lidhura me metrologjinë.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Agjencia e Metrologjisë së Kosovës**- organi i vetëm i administratës shtetërore për metrologji në Kosovë, në tekstin e mëtejme AMK;

1.2. **Metrologjia**- shkenca e matjes dhe aplikimi i saj;

1.3. **Matja** - procesi i marrjes në mënyrë eksperimentale të një apo më shumë vlerave të sasisë të cilat në mënyrë të arsyeshme mund t'i atribuohen një madhësie;

1.4. **Njësia matëse** - madhësia e vërtetë skalare, e përcaktuar dhe miratuar sipas konventës, me të cilën mund të krahasohet çdo madhësi tjetër e llojit të njëjtë për të shprehur proporcionin e të dy madhësive si një numër;

1.5. **Gjurmueshmëria metrologjike** - karakteristika e një rezultati të matjes sipas të cilës rezultati mund të ndërlidhet me një referencë përmes një zinxhiri të pakëputur të dokumentuar të kalibrimeve, secili duke kontribuar në pasigurinë e matjes;

1.6. **Kalibrimi**- operacioni i cili nën kushte specifike në hapin e parë krijon një marrëdhënie në mes të vlerave të sasisë me pasiguritë e matjes të ofruara nga etalonët e matjes dhe treguesit korrespondues me pasiguritë e ndërlidhura të matjes, ndërsa në hapin e dytë e shfrytëzon këtë informacion për të krijuar marrëdhënien për nxjerrjen e një rezultati të matjes nga treguesi;

1.7. **Mjetet matës** - në kuptimin e VIM-it, është termi që mbulon mjetet matëse të cilat mund të jenë objekt i kërkesave specifike dhe vlerësimit specifik të konformitetit, si vijon :

1.7.1. **Mjeti matës**-pajisja që përdoret për kryerjen e matjeve, vetëm ose në kombinim me një ose më shumë pajisje plotësuese;

1.7.2. **Sistemi matës**- seti i një apo më shumë mjeteve matëse dhe shpesh edhe i pajisjeve tjera, duke përfshirë ndonjë reagjent dhe furnizim, të bashkuar dhe të adaptuar për të dhënë informacionin e përdorur për të gjeneruar vlera të matura të madhësisë brenda intervaleve të caktuara për madhësitë e llojeve të posaçme;

1.7.3. **Masa materiale** - mjeti matës që riprodhon ose furnizon, në mënyrë të përhershme gjatë përdorimit të tij, madhësitë e një ose më shumë llojeve të caktuara, secili me një vlerë të përcaktuar të madhësisë;

1.8. **Etaloni i matjes** - realizimi i përkufizimit të një madhësie të caktuar, me vlerë të deklaruar të madhësisë dhe pasiguri të ndërlidhur të matjes, që përdoret si referencë;

1.9. **Etaloni shtetëror i matjes** - etaloni i matjes që njihet nga autoriteti shtetëror për të shërbyer në një shtet apo ekonomi si bazë për përcaktimin e vlerave të madhësisë për etalonët tjerë matës lidhur me llojin e madhësisë në fjalë;

1.10. **Materiali referent** - materiali që është mjaftueshëm homogjen dhe stabil që i referohet karakteristikave të posaçme, i cili është përcaktuar se është i përshtatshëm për përdorimin e synuar në matjen ose në ekzaminimin e karakteristikave nominale;

1.11. **Materiali referent i certifikuar** - materiali referent i shoqëruar nga dokumentacioni i lëshuar nga një trup autoritativ dhe që ofron një ose më shumë vlera të karakteristikës së posaçme me pasiguritë e ndërlidhura dhe gjurmueshmërinë, duke përdorur procedura të vlefshme;

1.12. **Verifikimi i mjetit matës** - procedura për vlerësimin e konformitetit (tjetër prej vlerësimit të tipit) e cila rezulton me ngjitjen e një shenje të verifikimit dhe/ose lëshimin e certifikatës së verifikimit;

1.13. **Verifikimi fillestar** - verifikimi i një mjeti matës i cili nuk është verifikuar më parë;

1.14. **Verifikimi i rregullt** - verifikimi i një mjeti matës pas verifikimit të mëparshëm. Verifikimi i rregullt përfshinë: verifikimin e detyrueshëm periodik, verifikimin pas riparimit dhe verifikimin vullnetar;

1.15. **Verifikimi i detyrueshëm periodik** - verifikimi pasues i një mjeti matës që kryhet periodikisht në intervale të caktuara sipas procedurës së paraparë me rregullore;

1.16. **Matje zyrtare** - një matje e kryer nga AMK ose nga subjekti i emëruar, në përputhje me vendimin për emërim. Matja zyrtare përdoret si evidencë e besueshme në procedurat dhe vendimmarrjet e organit Qeveritar apo të Gjykatave.

1.17. **Kontrolli ligjor metrologjik** - të gjitha aktivitetet ligjore të metrologjisë;

1.18. **Kontrolli ligjor i mjeteve matëse** - termi i përgjithshëm që përdoret për të caktuar në nivel global operacionet ligjore të cilave mund t'i nënshtrohen mjetet matëse, p.sh. aprovimi i tipit, verifikimi, etj;

1.19. **Mbikëqyrja metrologjike** - aktivitet i kontrollit ligjor metrologjik për të kontrolluar respektimin e ligjeve dhe rregulloreve të metrologjisë;

1.20. **Mbikëqyrja e tregut** - mbikëqyrja metrologjike që synon mjetet matëse dhe para-paketimet që kanë për qëllim të vendosen në treg dhe/ose vihen në përdorim për herë të parë, për të siguruar që të gjitha elementet e sistemit për vlerësimin e konformitetit funksionojnë si duhet, duke rezultuar me përputhshmëri të përgjithshme të produkteve me dispozitat e rregulloreve të aplikueshme në mbarë vendin ose në zonën e tregut të lirë;

1.21. **Mbikëqyrja e përdorimit të mjeteve matëse** - pjesë e mbikëqyrjes metrologjike e cila ka të bëjë me ekzaminimin nëse mjetet që i nënshtrohen kontrollit ligjor metrologjik, përdoren në mënyrën e duhur;

1.22. **Akreditim** - vërtetim nga organi shtetëror për akreditim që një trup për vlerësimin e konformitetit i plotëson kërkesat e përcaktuara me standardet e harmonizuara dhe kërkesa të tjera shtesë, përfshirë ato të përcaktuara në skemat relevante sektoriale, për të kryer aktivitete specifike për vlerësimin e konformitetit;

1.23. **Vendosja në treg** - vënia për herë të parë në dispozicion në treg e një mjeti matës ose një para-paketimi;

1.24. **Vlerësimi i konformitetit**- demonstrimi se janë përmbushur kërkesat e caktuara që kanë të bëjnë me një produkt, proces, sistem, person ose trup;

1.25. **Parapaketimi** - kombinimi i një produkti dhe materiali paketues në të cilin është parapaketuar;

1.26. **Shishja si enë matëse (SHEM)** - një enë matëse, zakonisht e quajtur shishe, e prodhuar nga xhami ose ndonjë substancë tjetër që ka ngurtësi dhe stabilitet të tillë që ofron garanci të njëjtë sikurse xhami, kur këto enë:

1.26.1 janë të mbyllur me tapë ose të dizajnuar që të mbyllen me tapë dhe janë të krijuar për ruajtje, transportim ose dërgim të lëngjeve,

1.26.2 kanë kapacitet nominal gjithëpërfshirës ndërmjet 0,05 litra dhe pesë (5) litra,

1.26.3 kanë karakteristika metrologjike (karakteristika të dizajnit dhe njëtrajtshmëri të prodhuar) të tilla që të mund të përdoren si enë matëse , d.m.th. kur të jenë mbushur në një nivel të caktuar ose në një përqindje të caktuar të kapacitetit të tyre më të lart përbërjet e tyre mund të maten më saktësi të mjaftueshme;

1.27. **Tipi i mjetit matës** - modeli përfundimtar i një mjeti matës ose moduli (përfshirë një familje të mjeteve ose moduleve) prej të cilave janë përcaktuar si duhet të gjitha elementet që prekin karakteristikat metrologjike

1.28. **Vlerësimi i tipit të mjeteve matëse** - procedura e vlerësimit të konformitetit për një ose më shumë mostra të një tipi të identifikuar (model) të mjeteve matëse që rezulton me një raport të vlerësimit dhe/ose certifikatë të vlerësimit

1.29. **Aprovimi i tipit** - vendimi i rëndësishëm ligjor, i bazuar në shqyrtimin e raportit të vlerësimit të tipit, kur tipi i një mjeti matës përputhet me kriteret relevante të parashikuara me ligj dhe rezultatet gjatë lëshimit të certifikatës për aprovimin e tipit;

1.30. **Inspektimi** - ekzaminimi i një dizajni të produktit, produktit, procesit ose instalimit dhe përcaktimi i konformitetit të saj me kërkesat specifike ose në bazë të gjykitimit profesional me kërkesat e përgjithshme;

1.31. **Emërimi** – autorizim shtetëtor i një trupi për vlerësim të konformitetit që të kryen aktivitet të caktuar për vlerësim të konformitetit;

1.32. **NAWI** - nënkupton peshoret jo-automatike;

1.33. **CIPM** - Komisioni Ndërkombëtare për Pesha dhe Matje (Comité Interstates des Poids et Mesures);

1.34. **MRA** - Marrëveshja për njohjen e ndërsjellët (CIPM MRA) është korniza përmes së cilës Institutet Kombëtare të Metrologjisë demonstrojnë ekuivalentin ndërkombëtar të etalonëve të tyre të matjes dhe kalibrimit si dhe certifikatat e matjes të cilat i lëshojnë;

1.35. **ILAC** - është Organizata Ndërkombëtare për Trupat e Akreditimit “Laboratori Ndërkombëtar për Bashkëpunim të Akreditimit”;

1.36. **SI** - Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (Système Interstate D'unités);

1.37. **OIML** - Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore (Organisation Interstate de Métrologie Légale);

1.38. **CGPM** - Konferenca e Përgjithshme për Pesha dhe Matje (Conférence Générale des Poids et Mesures);

1.39. **VIM** - Fjalori Ndërkombëtar i Metrologjisë;

1.40. **VIML** - Fjalori Ndërkombëtar i Termeve në Metrologjinë Ligjore.

2. Për termet dhe përkufizimet që nuk përmenden në këtë ligj vlejnë përkufizimet e paraqitura në VIM dhe në VIML.

Neni 4

Vënia në dispozicion e rezultateve të matjes për publikun

Rezultatet e matjeve, të kryera me kërkesë të autoriteteve shtetërore ose që i shërbejnë nevojave të autoriteteve shtetërore dhe që kanë lidhje me transaksionet zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit, duhet të vihen në dispozicion të publikut, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI II

ORGANIZIMI I INFRASTRUKTURËS SË METROLOGJISË

Neni 5

Agjencia e Metrologjisë së Kosovës

1. Agjencia e Metrologjisë së Kosovës është organ i vetëm i administratës shtetërore, përgjegjës për fushën e metrologjisë dhe aplikimin e saj në Republikën e Kosovës.
2. AMK është organ i pavarur i administratës shtetërore, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
3. Struktura dhe organizimi i AMK-së, siguron paanshmëri dhe objektivitet në marrjen e vendimit për detyrat në metrologji.
4. AMK udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm.
5. Ligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës do të zbatohet për themelimin, organizimin dhe funksionimin e AMK-së.
6. Organizimi dhe struktura e AMK-së, rregullohet përmes aktit nënligjor të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 6

Funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë të Metrologjisë së Kosovës

1. AMK- është përgjegjëse për:
 - 1.1. Implementimin e politikës shtetërore të metrologjisë;
 - 1.2. Hartimin e legjislacionit në fushën e metrologjisë;
 - 1.3. Zbatimin e akteve ligjore për fushën e metrologjisë në nivel shtetëror;
 - 1.4. Zhvillimin, realizimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen në mënyrë të vazhdueshme të etalonëve shtetëror të matjeve në Republikën e Kosovës;
 - 1.5. Sigurimin e gjurmueshmërisë metrologjike ndaj SI-së, në varësi të madhësisë, ose duke realizuar përkufizimin e njësisë ose duke mbajtur, mirëmbajtur dhe duke përmirësuar vazhdimisht etalonët shtetërore të matjes që janë të gjurmueshëm në një institut të huaj;
 - 1.6. Kryerjen e aktiviteteve kërkimore dhe zhvillimore për përmirësimin e etalonëve shtetëror;
 - 1.7. Kryerjen e kontrollit ligjor të mjeteve matëse;

1.8 Kryerjen e kontrollit sasior të produkteve të parapaketuara dhe të shisheve si enë matëse, me qëllim të kontrollit të përmbushjes së kërkesave metrologjike;

1.9 Përcaktimin e procedurës së mbajtjes së regjistrit të prodhuesve dhe të importuesve të parapaketimeve dhe shisheve si enë matëse.

1.10 Kryerjen e mbikëqyrjes metrologjike;

1.11 Mbikëqyrjen e trupit për vlerësim të konformitetit (trupi i emëruar) të cilit i janë ndarë detyrat për zbatimin e akteve nënligjore të metrologjisë;

1.12 Autorizimin e operatorit ekonomik për riparimin dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim;

1.13 Kryerjen e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse;

1.14 Kryerjen e aktiviteteve për ekspertizën metrologjike;

1.15 Mbajtjen e regjistrit të mjeteve matëse të cilat janë subjekt i kontrollit ligjor metrologjik dhe të dhëna tjera të përshkruara;

1.16 Ofrimin e ndihmës profesionale dhe kryerjen e trajnimeve për aktivitetet në fushën e metrologjisë;

1.17 Bashkëpunimin me autoritetet tjera shtetërore, veçanërisht me ato të infrastrukturës së cilësisë dhe autoritetet e mbrojtjes së konsumatorit;

1.18 Të shërbyer si referencë shtetërore për autoritetin shtetëror të akreditimit për fushën e laboratorëve të kalibrimit, për aftësitë kalibruese/testuese dhe etalonet e matjeve;

1.19 Kryerjen e veprimtarive tjera në fushën e metrologjisë në përputhje me ligjin;

1.20. Përfaqësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare të metrologjisë, kryerjen e detyrave që dalin nga anëtarësimi në këto organizata, dhe vendosjen e bashkëpunimit në fushën e metrologjisë;

1.21 Pjesëmarrjen në aktivitete të ngjashme ndërkombëtare, ndërkrahasimet dhe grupet e dedikuara të punës;

1.22 Studimin e nevojave për pajisje të kalibrimit dhe testimit, të nevojshme për zbatimin e akteve nënligjore të metrologjisë ligjore dhe organizimin e këtyre pajisjeve në përputhje me nevojat shtetërore.

2. Struktura e sistemit të metrologjisë integron bartësit e përcaktuar të etalonëve shtetëror të matjes, trupat e emëruar për vlerësim të konformitetit duke përfshirë laboratorët e kalibrimit dhe testimit, operatorët ekonomik që kryejnë shërbime metrologjike dhe organizatat tjera që janë të përfshira në punën e metrologjisë.

3.AMK do të konsultohet me institucionet tjera kompetente për hartimin e politikës shtetërore të metrologjisë dhe do të arrijë konsensus për të:

3.1.Siguruar që ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me metrologjinë i marrin parasysh dhe janë në pajtueshmëri me dispozitat relevante ndërkombëtare që ndërlidhen me metrologjinë, dhe

3.2.Siguruar që ligjet dhe rregulloret nuk ua ndalojnë autoriteteve shtetërore që të lidhin marrëveshje ndërkombëtare.

4.AMK në mënyrë aktive bashkëpunon me autoritetet shtetërore përgjegjëse për aktivitetet e standardizimit dhe akreditimit, si dhe me organizatat relevante metrologjike ndërkombëtare.

Neni 7 Këshilli i Metrologjisë

1.Këshilli i Metrologjisë është trup këshillëdhënës, i cili funksionon në kuadër të AMK-së.

2.Këshilli i Metrologjisë identifikon prioritetet në fushën e metrologjisë në vend, propozon investime, aktivitete shkencore dhe trajnuese, jep këshilla profesionale lidhur me vlerësimet për çështje të metrologjisë.

3. Mënyra e themelimit të Këshillit të Metrologjisë, fushëveprimi si dhe përzgjedhja dhe caktimi i anëtarëve, rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministria.

Neni 8 Strategjia dhe politika shtetërore e metrologjisë

1. AMK-ja është përgjegjëse për hartimin, zhvillimin dhe implementimin e strategjisë dhe politikës shtetërore të metrologjisë e cila i dërgohet Qeverisë për aprovim.

2.Kjo strategji dhe politikë shtetërore implementohet në bashkërendim me të gjitha strukturat e ministrive përkatëse dhe do t'i adresojë qëllimet në vijim:

2.1.mbrojtjen e konsumatorit dhe mbrojtjen e mjedisit;

2.2.matjet zyrtare;

2.3.përkrahjen e industrisë duke përfshirë konsulencën për rregulloret teknike;

2.4.tregtinë e ndershme;

2.5.njohjen ndërkombëtare;

2.6.deklaratën për organizimin e infrastrukturës së metrologjisë, duke përfshirë Këshillin e Metrologjisë me përfaqësuesit e të gjitha palëve të interesit;

2.7.deklaratën për kompetencën e laboratorëve lidhur me personat përgjegjës;

2.8. arsimimin dhe/ose aftësimin në metrologji; dhe

2.9. njohjen reciproke të rezultateve të testimit/kalibrimit ose certifikatave.

3. AMK harton politika në fushën e Metrologjisë, të cilat në Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat, inkorporohen në Objektivin strategjik: Zhvillimi dhe promovimi i infrastrukturës së cilësisë duke e përafuar legjislacionin si dhe anëtarësimin në organizatat relevante evropiane dhe ndërkombëtare si dhe Objektivin specifik: Rritja dhe përmirësimi i shërbimeve të akreditimit, standardizimit dhe metrologjisë.

Neni 9 Njësitë matëse ligjore

1. Me qëllim që të sigurohet njëtrajtshmëri e matjeve, në Republikën e Kosovës do të përdoren:

1.1 Njësitë e Sistemit Ndërkombëtar të Njësive të Matjes (SI), të miratuara nga Konferenca e Përgjithshme e Peshave dhe Masave dhe të rekomanduara nga OIML për qëllime ligjore;

1.2. Njësitë e përdorura për madhësitë që nuk mbulohen nga SI, siç përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.

1.3 -Njësitë e zakonshme të vendosura nga Qeveria.

2. Me akt nënligjor përcaktohet përdorimi i njësive SI dhe njësive tjera jashtë sistemit SI, kur ato përdoren ndërkombëtarisht dhe nuk rrjedhin drejtpërdrejt nga sistemi SI.

KAPITULLI III ETALONËT SHETETËROR TË MATJES DHE GJURMUESHMËRIA METROLOGJIKE

Neni 10 Etalonët shtetëror të matjes

1. Sistemi i etalonëve shtetëror të matjes dhe materialet referente në Kosovë do të krijohen sipas nevojave të shtetit, për të ofruar gjurmueshmëri të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) dhe për të siguruar pajtueshmëri dhe pranim ndërkombëtar. Etalonët shtetëror të matjes në të gjitha rastet janë etalonët me saktësinë më të lartë të matjes në vend. Etalonët shtetëror të matjes janë pjesë e infrastrukturës shtetërore metrologjike të Kosovës.

2. AMK është përgjegjëse për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e etalonëve shtetëror të matjes duke ofruar gjurmueshmëri deri te Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (SI).

3.AMK mund ta njohë zyrtarisht çdo etalon që është realizuar, ruajtur dhe mirëmbajtur nga një subjekt juridik i themeluar në Kosovë, si Etalon Shtetëror i Matjes në lidhje me gjurmueshmërinë deri te Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (SI).

4.AMK bashkëpunon me organizatat tjera publike dhe/ose private me qëllim që të identifikojë mundësinë që etalonë të caktuar shtetëror të zhvillohen dhe ruhen për të përkrahur Infrastrukturën Shtetërore të Cilësisë.

5.Për madhësitë, gjurmueshmëritë e të cilave mund të merren lehtë nga përdoruesit dhe nga laboratorët e kalibrimit dhe testimit drejtpërsëdrejti prej etalonëve shtetëror të vendit tjetër; dhe kur gjurmueshmëria e ofruar nga referimi i drejtpërdrejt është i pranueshëm në skemën shtetërore të akreditimit, etaloni shtetëror i matjes mund të mos jetë i nevojshëm. AMK do të marrë parasysh krijimin e një infrastrukture metrologjike rajonale të gjurmueshmërisë me një apo më shumë shtete fqinje ose organizata konkurrenente.

6. Përgjegjësia për pajtueshmërinë me kërkesat e aplikueshme për ruajtjen dhe përdorimin e etalonëve shtetëror mbetet te menaxhmenti i lartë i mbajtësve të tyre.

7. Kërkesat që duhet t'i përmbush një etalon referent i matjes në mënyrë që të deklarohet si një etalon shtetëror i matjes, kushtet dhe arsyet për anulimin e deklaratës, mirëmbajtjen e nevojshme dhe mënyrat e përdorimit të etalonëve shtetëror të matjes rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga MTL.

Neni 11

Materialët referente

1. Sistemi i etalonëve shtetëror të matjes përfshinë një sistem që ofron materiale referente të certifikuar.

2. Materialët referente të certifikuar janë materiale, përbërja apo karakteristikat e të cilave janë certifikuar nga organizata të destinuar dhe/ose të akredituar për të ofruar gjurmueshmëri për Sistemin Ndërkombëtar të Mjeteve (SI) dhe për të ofruar pajtueshmëri dhe pranim ndërkombëtar.

3. Materiali referent i certifikuar shoqërohet nga një certifikatë e cila përshkruan një apo më shumë vlera të karakteristikave bashkë me pasiguritë dhe nivelin e besueshmërisë. Certifikata duhet të dokumentojë dhe konfirmojë se janë zbatuar procedurat e aplikueshme për konfirmimin e karakteristikave dhe gjurmueshmërinë.

4. Ministria i'a ndanë këto detyra një ose më shumë subjekteve juridike të destinuar.

5. Procedura për importimin, përgatitjen dhe certifikimin e një materiali referent të certifikuar rregullohet me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 12

Gjurmueshmëria e rezultateve të matjes

1. Për zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore që i përcaktojnë kërkesat për matjet, për mjetet matëse, për peshoret jo-automatike, për para-paketimet duke përfshirë SHEM, kërkohet gjurmueshmëria për realizimin e SI-së dhe ajo mund të merret:

1.1. përmes sistemit të etalonëve shtetëror të matjes dhe materialeve referente të certifikuar të përcaktuara në Nenet 10 dhe 11 të këtij Ligji.

1.2. përmes gjurmueshmërisë për etalonët e njohur shtetëror të matjes ose materialet referente të certifikuar të shteteve tjera kur shkalla e pasigurisë së sistemit të etalonëve shtetëror të matjes nuk është e mjaftueshme ose kur sistemi nuk e mbulon madhësinë e konsideruar.

2. Për të konfirmuar nëse etalonët e huaja të matjeve dhe etalonët shtetëror të matjes plotësojnë kërkesat e nevojshme për gjurmueshmërinë e rezultateve matëse, duhet të vërtetohet se politika e ILAC-ut për gjurmueshmërinë dhe shpërndarja e SI-së është zbatuar. Referenca duhet të bëhet në CIPM MRA dhe laboratorë të akredituar nga organet kombëtare të akreditimit të cilat janë nënshkruese të ILAC MRA ose Marrëveshjet rajonale të njohura nga ILAC.

3. Rezultatet e certifikuar të kalibrimit, rezultatet e testimit dhe rezultatet e matjes të përcaktuara nga AMK dhe subjektet që mirëmbajnë dhe përdorin etalonët shtetëror të matjes në Kosovë, do të jenë të gjurmueshme për realizimin e SI-së dhe paraqiten në përputhshmëri me rekomandimet e CGPM-së dhe OIML-së, si dhe me etalonë relevant të aplikueshëm shtetëror dhe ndërkombëtar.

4. Aftësia teknike e laboratorëve të AMK-së përcaktohet me akreditim.

5. Kërkesat metrologjike të gjurmueshmërisë rregullohen me akt nën-ligjor të nxjerra nga Ministria.

KAPITULLI IV

ETALONËT E MATJEVE, MJETET MATËSE DHE MATJET

Neni 13

Laboratorët kalibrues/testues

1. Laboratorët kalibrues/testues do ta përkrahin infrastrukturën shtetërore të metrologjisë së Kosovës për:

1.1. shërbimet e kalibrimit për të siguruar gjurmueshmëri për SI-në;

1.2. shërbimet e testimit të ofruara nga laboratorët e testimit;

1.3. shërbimet për mirëmbajtjen e mjeteve matëse.

2. Ministria mund të emërojë trupa për të kryer detyrat që kanë të bëjnë me vlerësimin e konformitetit, verifikimin ose inspektimin gjatë zbatimit të akteve nënligjore të metrologjisë ligjore. Këta trupa duhet të jenë kompetent dhe të paanshëm. Ata duhet të kryejnë detyrat në mënyrë jo diskriminuese.

3. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji duhet të kërkojnë që trupat për implementim që janë përgjegjës për detyra të caktuara të jenë të akredituar.

4. Mënyra e emërimit për trupat për vlerësimin e konformitetit rregullohet me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 14

Metrologjia Industriale - Kalibrimi i etaloneve të matjes dhe mjeteve matëse

1. Kalibrimi i etaloneve të matjeve dhe mjeteve matëse kryhet në laboratorët e kalibrimit, me kërkesën e përdoruesit.

2. Gjurmueshmëria e etaloneve të matjes dhe mjeteve matëse sigurohet me anë të kalibrimit ose me materialet referuese të certifikuara.

3. Për të siguruar gjurmueshmëri metrologjike përdoren etalonët e matjes me gjurmueshmëri të dokumentuar në përputhshmëri me Nenin 12 të këtij Ligji. Gjurmueshmëria e rezultateve të matjes, për një etalon matës, vërtetohet përmes certifikatës së kalibrimit.

4. Varësisht nga kërkesat e aplikueshme dhe përdorimi i tyre, mjetet matëse që janë objekt i kontrollit ligjor metrologjik mund të kalibrohen. Me përjashtim të rasteve të veçanta të përcaktuara në aktet nënligjore të metrologjisë në fuqi, kalibrimi i mjeteve matëse është një vendim që i takon ekskluzivisht përdoruesit të mjetit matës.

5. Infrastruktura e shërbimeve të laboratorëve kalibrues në Kosovë do të organizohet sipas dispozitave të Ligjit përkatës për Akreditim.

Neni 15

Vlerësimi i konformitetit të mjeteve matëse

1. Mjetet matëse që përdoren për arsye të interesit publik, për shëndetin publik, sigurinë dhe rendin, mbrojtjen e konsumatorit dhe mjedisit, për mbledhjen e taksave dhe detyrimeve, tregtisë së ndershme, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve, i nënshtrohen kontrollit metrologjik ligjor sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Aktivitetet e subjektit juridik që janë të ndërlidhura me mjetet matëse të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, janë subjekt i kontrollit ligjor metrologjik sipas emërimit dhe mbikëqyrës në bazë të këtij ligji.

3. Procedurat e vlerësimit të konformitetit të zbatueshme për mjetet matëse të cekura në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohen sipas akteve nënligjore përkatëse si më poshtë:

- 3.1.në fazën e projektimit të tipit të mjetit matës,
- 3.2.në fazën e prodhimit të mjeteve matëse duke përfshirë peshoret joautomatike, para-paketimet dhe SHEM, para vendosjes së tyre në treg,
- 3.3.në fazën e instalimit dhe vendosjes së mjetit matës në përdorim,
- 3.4.në fazën e riparimit të mjetit matës, para vendosjes së sërishme në treg, dhe
- 3.5.gjatë kohëzgjatjes së përdorimit të mjetit matës.

4. AMK mund të vendosë që të njohë sistemet ndërkombëtare apo të huaja të certifikimit kur ato ofrojnë besueshmëri ekuivalente.

5. AMK mban regjistër të certifikatave, të lëshuara në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni.

6. Trupat përgjegjëse për kryerjen e vlerësimit të konformitetit, gjatë punës së tyre mund t'i pranojnë dhe shfrytëzojnë, rezultatet e sistemeve ndërkombëtare apo të huaja të vlerësimit të konformitetit, me kusht që shkalla e besueshmërisë të jetë e njohur si ekuivalente me procedurat shtetërore të Kosovës.

KAPITULLI V KONTROLLI LIGJOR METROLOGJIK

Neni 16 Mjetet matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Mjetet matëse që përdoren në fushat e përcaktuara në nenin 15, paragraf 1 të këtij ligji, i nënshtrohen kontrollit ligjor metrologjik në pajtueshmëri me procedurat e vlerësimit të konformitetit si në vijim:

- 1.1. aprovimi i tipit;
- 1.2. verifikimi fillestar dhe
- 1.3. verifikimi pasues.

2. Kategoritë e mjeteve matëse që përdoren në fushat e përcaktuara në nenin 15, procedurat e vlerësimit të konformitetit që zbatohen për secilin mjet matës dhe periudha maksimale kohore ndërmjet dy verifikimeve metrologjike të njëpasnjëshme, duhet të rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria.

3. Për secilën kategori të mjeteve matëse të përcaktuara me akt nënligjor nga paragrafi 2 i këtij neni, Ministria do të nxjerrë akte nënligjore të cilat përcaktojnë kërkesat specifike tekniko-metrologjike në përputhje me Rekomandimet e OIML-së, Standardet ISO, Direktivat e BE-së dhe dokumentet tjera relevante ndërkombëtare.

Neni 17

Miratimi i tipit të mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Procedurat për vlerësim të konformitetit për mjetet matëse të cilat janë subjekt i Rregulloreve për Mjete Matëse dhe Peshoret Jo-automatike do të realizohen në pajtueshmëri me këto rregullore.
2. Për mjetet matëse të cilat nuk janë subjekt i Rregulloreve për Mjete Matëse dhe Peshoret Jo-automatike, Drejtori i Përgjithëm i AMK-së, miraton tipin e mjeteve matëse, pas rekomandimit të zyrtarëve përgjegjës të AMK-së, kur ky mjet matës i plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike të parapara.
3. Drejtori merr vendim për refuzim të tipit të mjetit matës apo heqjen nga tregu të mjeteve matëse, pas rekomandimit të zyrtarëve përgjegjës të Agjencisë, kur ky mjet matës nuk i plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike të kërkuara, të përcaktuara për një procedurë testimi.
4. Kundër vendimit për refuzimin apo heqjen e mjeteve matëse, mund të bëhet ankesë pranë komisionit profesional për ankesa i cili formohet me vendim të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
5. Me akt nënligjor përcaktohen procedurat e miratimit të tipit të mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 18

Certifikatat dhe shenjat e konformitetit të lëshuara jashtë vendit

1. AMK mund të pranojë certifikatat dhe dokumentet e konformitetit të lëshuara jashtë vendit, nëse ato janë në pajtueshmëri me Direktivat e zbatueshme të Bashkësisë Evropiane për fushën e metrologjisë.
2. AMK mund të pranojë raportet e testimit dhe të verifikimit, nëse ato janë lëshuar sipas kërkesave të Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore.
3. AMK mban regjistër të mjeteve matëse që lejohen të vendosen në treg në Republikën e Kosovës, të cilat posedojnë certifikatat dhe shenjat e konformitetit, të lëshuara në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 19

Verifikimi fillestar

1. Për mjetet matëse të reja, të cilat nuk janë të përfshira në Rregulloren për Mjete Matëse dhe Peshoret Jo-automatike, dhe për të cilët është lëshuar një certifikatë e aprovimit të tipit, do të zbatohet verifikimi fillestar.

2. Mjeti matës duhet të paraqitet për verifikim fillestar nga një prodhues vendor, një përfaqësues/importues i autorizuar ose një distributor i autorizuar.

Neni 20

Vendosja në treg e mjeteve matëse ligjërish të kontrolluara

1. Në Republikën e Kosovës mund të vendosen në treg dhe/ose të vihen në përdorim vetëm ato mjete matëse të cilat:

1.1. i plotësojnë kërkesat nga ky ligj;

1.2. i plotësojnë kërkesat tekniko metrologjike të përcaktuara me dispozita në zbatim të këtij ligji, si dhe;

1.3. i kanë kaluar procedurat e përcaktuara të vlerësimit të konformitetit.

2. Prodhuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, është përgjegjës për kryerjen e procedurave të vlerësimit të konformitetit dhe garanton se mjeti matës përputhet me kërkesat metrologjike të përcaktuara.

3. Mjetet matëse të cilat i plotësojnë kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet që para se të vendosen në treg, të jenë të shënuara me shenja të përshkruara të konformitetit dhe të përcillen me dokumente të konformitetit sipas dispozitave ligjore.

4. Mjetet matëse në përdorim duhet të përdoren në përputhje me kërkesat për atë tip të mjetit matës, në përputhje me dokumentet e konformitetit dhe me udhëzimet e prodhuesit të mjetit matës.

5. Mjetet matëse që nuk plotësojnë kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilat nuk janë shënuar dhe nuk posedojnë dokumentet e konformitetit sipas kërkesave metrologjike, nuk lejohen të vendosen në treg dhe/ose të vihen në përdorim.

Neni 21

Shenjat e verifikimit

1. Nëse mjetet matëse janë në pajtueshmëri me kërkesat e verifikimit fillestar dhe verifikimit pasues periodik, AMK ose trupat e emëruara të vlerësimit të konformitetit, e vendosin në mjetin matës shenjën e verifikimit dhe lëshojnë certifikatën e verifikimit.

2. Paraqitja grafike, dimensionet e shenjave të verifikimit dhe karakteristikat e certifikatës së verifikimit përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

3. Shenja e konformitetit, shenja plotësuese e metrologjisë dhe shenjat/plombat siguroese të vendosura në mjetet e caktuara matëse, të cilat vendosen në treg sipas rregullores për mjete matëse dhe rregullores për peshoret joautomatike, konsiderohen të jenë shenja të konformitetit. Deklarata e konformitetit në këtë rast konsiderohet e barazvlefshme me certifikatën fillestare të verifikimit.

4. Shenjat e metrologjisë - plombat që aplikohen në mjetet matëse, kanë të njëjtën mbrojtje ligjore sikurse çdo plumbë në pajtueshmëri me ligjin përkatës të Republikës së Kosovës.

5. Mjetet matëse që nuk janë në konformitet me kërkesat ligjore të aplikueshme, shënjohen si të refuzuara, dhe/ose largohen shenjat e verifikimit, apo detyrohen që të jenë në konformitet, të riparohen, ose të tërhiqen nga tregu.

Neni 22

Personat përgjegjës për mjetet matëse ligjore në përdorim

1. Përgjegjës për mjetet matëse ligjore në përdorim është shfrytëzuesi, i cili duhet:

1.1. të përdorë vetëm ato mjete matëse të cilat janë të verifikuara;

1.2. të mbajë mjetet matëse në gjendje teknike që këto të sigurojnë saktësi të matjes;

1.3. të paraqes në verifikim mjetet matëse që janë në përdorim, në pajtim me këtë ligj;

1.4. të përdorë mjetet matëse ligjore në përputhje me destinimin e tyre;

1.5. të mbajë evidencë rreth mirëmbajtjes dhe verifikimit të mjeteve matëse ligjore në përdorim, kur kjo është e përcaktuar.

2. Mjeti matës ligjor, që nuk është në përdorim, duhet të jetë i shënjuar në mënyrë të dukshme, me shenjëën “Mjeti matës jashtë përdorimit”.

Neni 23

Verifikimi pasues i mjeteve matëse ligjorisht të kontrolluara

1. Të gjitha mjetet matëse në përdorim duhet të jenë të gjurmueshme deri te etalonët shtetëror, respektivisht etalonët ndërkombëtar, siq është përcaktuar në nenin 12 të këtij ligji.

2. Mjetet matëse në përdorim, duhet të plotësojnë kërkesat sipas tipit të miratuar të mjetit matës dhe/ose kërkesat e përcaktuara metrologjike.

3. Me miratim të tipit të mjeteve matëse përcaktohet përdorshmëria e mjetit matës, ndërsa përmbushja e kërkesave metrologjike vërtetohet me verifikim.

4. Verifikimi i mjeteve matëse ligjorisht të kontrolluara mund të jetë fillestar, i rregullt, jo i rregullt dhe i jashtëzakonshëm.

5. Përgjegjës për sigurimin e verifikimit të rregullt dhe jo të rregullt të mjetit matës ligjor është vet shfrytëzuesi.

6. AMK ose një subjekt juridik i emëruar është i detyruar të lëshojë certifikatën e verifikimit me kërkesën e aplikantit, edhe nëse mjeti matës ka të fiksuar tashmë shenjëën e verifikimit.

7. Mjetet matëse, të cilat nuk kanë nevojë të verifikohen, duhet të mirëmbahen rregullisht. Procedura, përmbajtja dhe intervalet, kur kryhet mirëmbajtja e rregullt, përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 24 **Verifikimi i rregullt i mjeteve matëse**

1. Verifikimi i rregullt i mjeteve matëse bëhet në afate kohore të përcaktuara, për llojet e caktuara të mjeteve matëse.
2. Subjektet juridike të cilët shesin energji termike, energji elektrike, ujë apo gaz dhe të gjithë personat fizik apo juridik që posedojnë mjete matëse ligjore, janë të detyruar të përkujdesen për verifikim të rregullt të mjeteve matëse të energjisë termike, matësit e gazit, matësit e ujit dhe matësit e energjisë elektrike.
3. Me akt nënligjor përcaktohen mënyrat dhe afatet e verifikimit të rregullt të mjeteve matëse.

Neni 25 **Verifikimi jo i rregullt i mjeteve matëse**

Verifikimi jo i rregullt i mjeteve matëse bëhet në rastet kur mjete matës ligjor nuk ka qenë në përdorim për shkak të defektit apo mangësive teknike, pas riparimit ose në rastin kur mjete nuk i është nënshtruar verifikimit të rregullt në afat kohor të paraparë.

Neni 26 **Verifikimi i jashtëzakonshëm i mjeteve matëse**

1. Verifikimi i jashtëzakonshëm i mjeteve matëse dhe kontrolli i matjeve zyrtare bëhet me ekspertizë metrologjike kur ka dyshime për keqfunksionimin e mjeteve matëse ligjore.
2. Kërkesën për verifikim të jashtëzakonshëm të mjeteve matëse ligjore mund ta bëjnë:
 - 2.1. Institucionet relevante që merren me mbikëqyrjen e tregut dhe mjeteve matëse që gjenden në treg;
 - 2.2. Subjekti juridik/pronari i mjeteve matëse;
 - 2.3. Përdoruesit e mjeteve matëse; dhe ,
 - 2.4. Konsumatorët të cilët konsiderojnë se janë dëmtuar nga mjetet matëse ligjore.
3. Me akt nënligjor përcaktohet procedura e verifikimit të jashtëzakonshëm dhe shpenzimet që dalin nga verifikimi i jashtëzakonshëm i mjeteve matëse dhe matjeve zyrtare .

Neni 27

Vlefshmëria e verifikimit të mjeteve matëse

1. Vlefshmëria e verifikimit të mjeteve matëse ligjore ndërpritet nëse:

- 1.1. ka skaduar validiteti i verifikimit;
- 1.2. në mjetin matës janë bërë ndryshime të cilat mund të ndikojnë në karakteristikat metrologjike të tij;
- 1.3. mjete matës është dëmtuar në atë mënyrë që ka mund të humbë ndonjë veti të rëndësishme që është objekt i verifikimit;
- 1.4. shenja e verifikimit është dëmtuar;
- 1.5. shihet qartë se mjete matës ka humbur vetitë e nevojshme metrologjike edhe nëse shenja e verifikimit nuk është e dëmtuar;
- 1.6. vendi i instalimit të mjeteve matëse është ndryshuar.

Neni 28

Etalonet e matjeve dhe materialet referente në metrologjinë ligjore

1. Për verifikimin e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara duhet të përdoren vetëm etalone matjeje të kalibruara, që kanë certifikatë kalibrimi të vlefshme dhe materiale referente të certifikuara, që kanë certifikatë materiali referent të vlefshëm.
2. Kalibrimi i etaloneve të matjeve dhe certifikimi i materialeve referente, që përdoren për verifikimin e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara, kryhet nga AMK apo nga laborator kalibrimi/testimi të akredituar.
3. Drejtori i Përgjithshëm i AMK-së rekomandon intervalet maksimale të kalibrimit për etalonët e matjes, që përdoren për verifikimin e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 29

Parapaketimet

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për para-paketimet individuale, të kombinuara, pa ambalazh mbështjellës dhe në enë matëse, që janë prodhuar, hedhur në treg ose ofruar për konsum të përgjithshëm.
2. Produktet e parapaketuara në kuptim të këtij ligji nuk konsiderohen mostrat falas, të cilat janë si produkte të parapaketuara, e të cilat përdoren për qëllime të marketingut.
3. Me akt nënligjor përcaktohen kriteret dhe masat e përgjithshme për parapaketimet që kontrollohen ligjërisht, kërkesat metrologjike për sasinë neto të parapaketimeve, diapazonet e detyrueshme për sasinë nominale të disa parapaketimeve, metodat referuese për kontrollin e sasisë neto të parapaketimeve, mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në parapaketime.

Neni 30

Shishet si enë matëse

1. Shishet si enë matëse përmbajnë shenjat që tregojnë vëllimin nominal dhe atë të mbushjes deri në nivelin e plotë si dhe me shenjën që identifikon prodhuesin e enës matëse.
2. Me akt nënligjor përcaktohen shishet që kontrollohen ligjërisht, kërkesat metrologjike për shishet si enë matëse, metodat referuese për kontrollin e vëllimit neto të shisheve, mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në shishet si enë matëse.

Neni 31

Vendosja në treg e parapaketimeve dhe e shisheve si enë matëse

1. Mallrat e parapaketuara dhe shishet si enë matëse, mund të vendosen në treg, vetëm nëse plotësojnë kërkesat metrologjike të përcaktuara me këtë ligj dhe kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara deri në kohën e blerjes.
2. Prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi është përgjegjës për përputhshmërinë e produkteve të para-paketuara dhe të shisheve si enë matëse, me masat e përcaktuara në këtë ligj.
3. Prodhuesi zbaton sistemin e tij të kontrollit të sasisë neto të parapaketimeve ose sistemin e kontrollit të vëllimit neto të shisheve si enë matëse të prodhuara.
4. Prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi është i detyruar të njoftojë AMK-në kur konstaton se parapaketimet ose shishet si enë matëse, të vendosura në treg nga ai, nuk përmbushin kërkesat metrologjike në mënyrë që të merren masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 32

Regjistrimi i prodhuesve dhe i importuesve

1. Regjistrimi i prodhuesve dhe i importuesve bëhet në bazë të kërkesës së tyre në AMK.
2. Mënyra dhe procedura e regjistrimit përcaktohet me akt nënligjor.
3. Prodhuesit dhe importuesit detyrohen të njoftojnë AMK-në për çdo ndryshim të kryer pas regjistrimit.

Neni 33

Miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve

1. AMK kryen mbikëqyrjen në vend të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve si dhe monitoron sistemin e kontrollit sasior të miratuar në kushtet e prodhuesit dhe në qoftë se është e nevojshme jep rekomandime për përmirësimin e tij.

2. Çdo prodhues është i obliguar që të marrë miratimin e AMK-së për sistemin e kontrollit sasior.
3. Regjistrimi i prodhuesve bëhet dhe ruhet vetëm nëse sistemi i tij i kontrollit sasior është miratuar.
4. AMK mund të njoh konformitetin e dispozitave shtetërore të parapaketimeve dhe shisheve si enë matëse që i bartin shenjat e konformitetit të ngjitura sipas rregulloreve ligjore të metrologjisë së shteteve tjera ose sipas sistemeve të shënimit të konformitetit të krijuara nga trupat tjerë ndërkombëtarë.

Neni 34

Aktet nënligjore të zbatueshme për fushat e interesit të posaçëm të qeverisë

1. Ky nen është i aplikueshëm - vetëm në rast se ka produkte me interes për disa fusha të rëndësishme për tregtinë e vendit, prodhimin ose pasurinë.
2. Ministria do t'i identifikojë fushat në të cilat duhet të hartohen aktet nënligjore si në vijim:
 - 2.1. Rregullorja për mjetet matëse;
 - 2.2. Rregullorja për peshoret jo-automatike;
 - 2.3. Rregullorja për produktet e para-paketuara;
 - 2.4. Rregullorja për shishet si enë matëse.

Neni 35

Trupat e emëruara për vlerësimin e konformitetit

1. Kur një trup për vlerësimin e konformitetit demonstroi konformitetin e tij me kriteret e caktuara me aktet nënligjore në fuqi, standardet dhe udhëzimet, vërtetohet se është në përputhshmëri me dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.
2. Për zbatimin e këtij Ligji, Ministria përmes akteve nënligjore duhet të kërkojë që trupat për vlerësimin e konformitetit që janë përgjegjës për fushat e aplikueshme të metrologjisë ligjore të jenë të akredituar.
3. Ministria me aktin nënligjor përkatës për mënyrën e emërimit për trupat për vlerësim të konformitetit, rregullon procedurat e vlerësimit për të emëruar trupat për vlerësimin e konformitetit në fushat specifike të metrologjisë ligjore.
4. Trupat e emëruar për vlerësimin e konformitetit mirëmbajnë bazën e të dhënave bashkë me regjistrat relevant për mjetet matëse që i janë nënshtruar punës së kontrollit metrologjik ligjor në pajtueshmëri me kompetencën e tyre.

5. Trupat e emëruar për vlerësimin e konformitetit marrin obligimin që të sigurojnë për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta në lidhje me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse.

6. Procedurat për organizimin dhe mënyrën se si ushtrohet kontrolli ligjor metrologjik për trupat e emëruar për vlerësim të konformitetit, përcaktohet me akt nënligjor për mbikëqyrjen metrologjike, i cili nxirret nga Ministria.

7. Kërkesat e aplikueshme për trupat e vlerësimit të konformitetit që ofrojnë shërbime të vlerësimit të konformitetit për fushën e metrologjisë ligjore, përcaktohen me akte nënligjore të cilat i nxjerrë Ministria, në përputhshmëri me Standardet e aplikuar.

Neni 36

Autorizimi i subjektit juridik për riparimin dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim

1. Drejtori i Përgjithshëm i AMK-së mund të autorizojë operatorin ekonomik i cili plotëson kushtet për kryerjen e riparimit dhe përgatitjen e mjeteve matëse ligjore për verifikim.

2. Subjekti juridik i autorizuar i cili bën riparimin dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të kryej verifikimin e mjeteve matëse.

3. Autorizimi mund t'i jepet operatorit ekonomik nëse:

3.1. posedon pajisje të nevojshme teknike dhe hapësirë për të kryer aktivitetet për të cilat kërkohet autorizimi;

3.2. ka siguruar gjurmueshmërinë e etalonëve dhe mjeteve matëse të cilat i përdorë,

3.3. punëson persona profesionalisht të aftësuar, për kryerjen e detyrave të parapara me autorizim;

3.4. jep garancion për kompensimin e dëmeve të shkaktuara me punën e tyre, dhe

3.5. nuk është në procedurë të falimentimit.

4. Me akt nënligjor përcaktohen kushtet dhe kriteret tekniko-metrologjike për autorizimin e subjektit juridik për kryerjen e veprimtarive për shërbimin e riparimit dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim.

Neni 37

Afat për lëshimin e autorizimit

1. Për autorizimin nga neni 36 i këtij ligji, në afat prej tridhjetë (30) ditë, nga dita e parashtrimit të kërkesës, Drejtori i Përgjithshëm i AMK-së lëshon vendimin për autorizim.

2. Me vendim për autorizimin, përcaktohet fusha dhe vëllimi i autorizimit.

3. Autorizimi vlen tri (3) vite.

Neni 38 **Anulimi i vendimit**

1. Vendimi për autorizimin mund të anulohet pjesërisht apo në tërësi, nëse subjekti:

1.1. nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara me këtë ligj, dispozitat për zbatimin e tij dhe me vendimin për autorizim;

1.2. nuk i kryen detyrat paraparë me ligj;

1.3. tregon mangësi profesionale dhe teknike në ushtrimin e detyrave në fushën e autorizimit;

1.4. me kërkesën e subjektit.

2. Subjektit të autorizuar të cilit i është anuluar vendimi, me arsyen se ai nuk ka punuar konform dispozitave, profesionalisht dhe në pajtim me autorizimin, nuk mund të parashtrij kërkesë të re për autorizim gjatë afatit kohor trevjeçar, nga dita e anulimit të tij.

Neni 39 **Pavlefshmëria e autorizimit**

1. Autorizimi bëhet i pavlefshëm kur:

1.1. mbaron afati i vlefshmërisë;

1.2. nxirret vendimi për revokimin e autorizimit;

1.3. i autorizuari heq dorë, me shkrim, nga autorizimi.

Neni 40 **Publikimi i vendimit të autorizimit**

Vendimi për autorizimin, ndryshimet dhe ndërprerjen e validitetit të autorizimit, publikohet në ueb faqe të AMK-së.

Neni 41 **Detyrimet e subjektit të autorizuar**

1. Subjekti i autorizuar duhet:

1.1. të kryej veprimtaritë e tij, konform dispozitave, me profesionalizëm dhe në pajtim me vendimin për autorizim;

1.2. të njoftoj menjëherë AMK-në për ndërprerjen apo ndryshimin e kushteve të autorizimit;

1.3. të udhëheqë detyrat për çështjet administrative, nga fusha për të cilën është autorizuar në pajtim me dispozitat, nëse me këtë ligj apo dispozitat për zbatimin e tij, nuk është rregulluar ndryshe;

1.4. në afatet e përcaktuara dhe në mënyrë të rregullt t'i paraqesë AMK-së të dhënat për aktivitetet për riparimin e mjeteve matëse.

2. Të paraqes në AMK informacion të domosdoshëm, brenda afatit të caktuar sipas procedurave për regjistrimin e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara në regjistrin përkatës.

Neni 42

Inspektimi, mbikëqyrja dhe vëzhgimi

1.AMK është autoriteti përgjegjës për:

1.1.mbikëqyrjen dhe vëzhgimin e trupave të cilëve u janë caktuar detyrat për zbatimin e rregulloreve të metrologjisë ligjore;

1.2.mbikëqyrjen e tregut për fushën e metrologjisë;

1.3.mbikëqyrjen e përdorimit të mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara, dhe

1.4.mbikëqyrja e obligimeve që rezultojnë nga rregulloret në fuqi që janë të ndërlidhura me këtë ligj.

2. Mbikëqyrja e tregut në fushën e metrologjisë dhe mbikëqyrja metrologjike kryhet nga inspektorët të cilët e kanë njohuri përkatëse për mjetet matëse dhe për procesin të cilin e mbikëqyrin.

3.Inspektorët e kanë autoritetin që të:

3.1. kërkojnë informacionin e nevojshëm për zbatimin e nenit 21 të këtij ligji;

3.2.ushtrojnë kontrollin ligjor për para-paketimet e përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji;

3.3.kërkojnë informacion përkitazi me obligimet që ky ligj i parasheh për prodhuesit, importuesit, instaluesit, riparuesit dhe përdoruesit e mjeteve matëse dhe prodhuesit dhe paketuesit e parapaketimeve, të cilat i nënshtrohen kontrollit ligjor;

3.4.kryejë inspektime për mjetet matëse që i nënshtrohen kontrollit metrologjik ligjor;

3.5.shenjojë me shenja të refuzimit dhe/ose largoj shenjën e konformitetit gjatë zbatimit të nenit 22 të këtij ligji, dhe

3.6.kryejë mbikëqyrje të trupave që janë caktuar për zbatimin e nenit 13 paragrafi 2 të këtij ligji.

4.Të gjeturat e inspektorëve lidhur me shkeljet e përcaktuara në nenin 46 të këtij ligji, mund t'i transmetohen autoriteteve administrative ose të prokurorisë për veprim të mëtutjeshëm.

5. Të gjithë personat që i nënshtrohen rregulloreve sipas këtij ligji janë të obliguar që tua lejojnë autoriteteve për zbatimin e ligjit që të kryejnë detyrat e mbikëqyrjes dhe që tu ofrojnë atyre informatat relevante sipas kërkesës.

6.Inspektorët e metrologjisë, në pajtueshmëri me Rregulloren për mjetet matëse dhe Rregulloren për peshoret jo-automatike, janë të autorizuar që të hyjnë në objektet e subjekteve juridike të cilët vendosin mjete matëse në treg ose në përdorim, si dhe që të hyjnë në objektet e përdoruesve të fundit të mjeteve matëse dhe të marrin veprime për zbatim të ligjit në rast nevojë.

7.Inspektorët e metrologjisë, pas prezantimit të kartës së identitetit të tyre dhe me qëllim të kryerjes së detyrave të tyre, e kanë të drejtën për qasje në të gjitha ndërmarrjet apo objektet tregtare ose automjetet, ku gjendet apo mund të jetë instaluar, mbajtur ose përdorur mjeti matës që është subjekt i kontrollit metrologjik ligjor.

8. Inspektorët e metrologjisë janë të autorizuar në bazë të procedurave gjyqësore shtetërore që të lëshojnë urdhëra për ndalim të përdorimit, mbajtje dhe tërheqje sa i përket çdo mjeti matës që i nënshtrohet kontrollit ligjor metrologjik dhe urdhëra për ndalim të shitjes, mbajtje dhe tërheqje të çdo artikulli të para-paketuar ose artikuj me shumicë që mbahen, ofrohen apo ekspozohen për shitje. Inspektorët e metrologjisë e kanë të drejtën e qasjes në objektet ku gjenden para-paketimet ose ku mund të mbushen, etiketohen, mbahen ose ofrohen për shitje.

9. Inspektorët e metrologjisë janë të autorizuar, sipas procedurave gjyqësore shtetërore, që të konfiskojnë, për ta përdorur si dëshmi, pa urdhër zyrtar, çdo mjet matës, pako ose artikull që gjendet duke u përdorur, mbajtur, ofruar ose ekspozuar për shitje apo që është shitur duke i shkelur kërkesat e metrologjisë ligjore.

10. Inspektorët e metrologjisë janë të autorizuar që të shqiptojnë masat administrative dhe kundërvajtëse.

11. Për mbikëqyrjen e kryer, inspektori i metrologjisë mban procesverbal, ku pasqyrohen të dhënat e marra. Ky procesverbal mbahet në dy kopje, njëra prej të cilave i dorëzohet subjektit të mbikëqyrur.

Neni 43 **Procedura e ankesave**

1. Kundër vendimit të AMK-së, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin për shqyrtimin e ankesave (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të vendimit.

2. Komisioni përbëhet prej tre (3) anëtarëve dhe atë dy anëtarë të përhershëm dhe një anëtarë caktohet nga rasti në rast, dhe formohet me vendim të Ministrit të MTI-së.

3. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vendosjen e të gjitha ankesave të parashtruara nga palët kundër vendimeve të AMK-së.
4. Komisioni e kryen punën e tij në mënyrë të pavarur, me ndershmëri, ndërgjegje dhe paanshmëri.
5. Për të gjitha çështjet lidhur me ankesat administrative që nuk janë të rregulluara në këtë ligj, aplikohen dispozitat përkatëse të ligjit në fuqi për procedurën administrative.
6. Kundër vendimit të komisionit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

KAPITULLI VI BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 44 Aktivitetet ndërkombëtare të AMK-së

1. AMK është anëtare e asociuar e organizatës Evropiane për Bashkëpunim në metrologjinë ligjore – WELMEC, ndërsa synon anëtarësimin e saj edhe në organizatat tjera ndërkombëtare/rajonale të metrologjisë.
2. Rezultatet e certifikuar të kalibrimit, rezultatet e testimit dhe rezultatet e matjeve të realizuara nga institutet kombëtare të metrologjisë, të cilat janë të gjurmueshme deri në Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI) dhe të cilat janë paraqitur në përputhshmëri me rekomandimet e CGPM-së dhe OIML-së, si dhe me standardet relevante ndërkombëtare, njihen nga AMK.
3. AMK ka kompetencë që të hyj në aranzhime dhe marrëveshje të ndërsjella me Institutet e Metrologjisë të shteteve tjera, për njohjen e certifikatave dhe raporteve të testimit apo shenjave të konformitetit, nëse ato janë në pajtueshmëri me dokumentet dhe rekomandimet e OIML-së, si dhe me dokumentet/standardet relevante ndërkombëtare në fushën e metrologjisë.
4. AMK është përgjegjëse për misione të metrologjisë shkencore dhe ligjore, po ashtu për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare duke përcaktuar ekuivalencën e sistemeve të metrologjisë në vendet pjesëmarrëse.

KAPITULLI VII PAGESAT DHE TARIFAT

Neni 45

Pagesat dhe tarifat e shërbimeve

1. Aktivitetet metrologjike të realizuara nga AMK dhe trupat e emëruara për vlerësim të konformitetit kryhen sipas tarifave të miratuara me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.
2. Trupat e emëruara për vlerësim të konformitetit dhe laboratorët e etaloneve kombëtare jashtë AMK-së, për kryerjen e shërbimeve të ndryshme metrologjike, përdorin tarifa të miratuara me akt nënligjor nga Ministria.
3. Detyrat për vlerësimin e konformitetit dhe verifikimit, të cilat kryhen nga trupat e emëruara, do të realizohen sipas kërkesës së personit fizik ose juridik që është përgjegjës për konformitet.

Neni 46

Dispozitat ndëshkuese

1. Inspektori i metrologjisë për shkeljet e konstatuara me këtë ligj shqipton këto gjoba:
 - 1.1. Me gjobe prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) euro, ndëshkohet subjekti juridik, ndërsa me gjobë prej dyqindpesëdhjetë (250) deri shtatëqindpesëdhjetë (750) euro personi fizik dhe personi përgjegjës i subjektit juridik në rastet si vijon:
 - 1.1.1. për përdorimin e njësive matëse në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave nga akti nënligjor që rregullon përdorimin e njësive matëse, sipas nenit 9 të këtij ligji;
 - 1.1.2. mbajtjen në biznesin e vet të një mjeti matës që nuk është në përdorim dhe nuk është shënuar në mënyrë të dukshme me shenjën “Mjeti matës jashtë përdorimit” sipas nenit 22 paragrafi 2 të këtij ligji;
 - 1.1.3. mos sigurimin e verifikimit periodik të mjeteve matëse në intervalet e përshkruara sipas nenit 22 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. të këtij ligji;
 - 1.1.4. mosvënien në dispozicion për verifikim periodik të mjeteve matëse pas riparimit, sipas nenit 25 të këtij ligji,
 - 1.1.5. mosplotësimin e kërkesave për regjistrim, të përcaktuara në nenin 32 të këtij ligji.
 - 1.2. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri tremijë (3.000) euro, ndëshkohet subjekti i autorizuar ndërsa me gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) euro personi fizik dhe personi përgjegjës i subjektit të autorizuar në rastet si vijon:

1.2.1. për mos mirëmbajtjen e rregullt të mjeteve matëse, sipas nenit 23 paragrafin 7 të këtij ligji;

1.2.2. prodhimit, importimit dhe hedhjes në treg të produkteve të parapaketuara dhe shisheve si enë matëse, që nuk plotësojnë kërkesat metrologjike dhe nuk kanë mbishkrimet dhe shenjat e përcaktuara, sipas nenit 31 të këtij ligji;

1.2.3. veprimi në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenet 38 dhe nenin 41 të këtij ligji.

1.3. Me gjobe prej njëmijepesëqind (1.500) deri pesëmijë (5.000) euro, ndëshkohet subjekti juridik ndërsa me gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) euro personi fizik dhe personi përgjegjës i subjektit juridik në rastet si vijon:

1.3.1. hedhja në treg dhe vënia në përdorim e mjeteve matëse në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara sipas nenit 31 paragrafin 1. të këtij ligji;

1.3.2. përdorimi i mjeteve matëse ligjore në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara sipas nenit 22, paragrafin 1, nën-paragrafi 1.1, 1.2,1.3 dhe 1.4 të këtij ligji;

1.3.3. veprimi në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara sipas nenit 15 paragrafi 1, neni 16 paragrafi 1 dhe neni 20 paragrafi 1, të këtij ligji;

1.3.4. mosdhënia e informacionit dhe e të dhënave të domosdoshme inspektorit të metrologjisë për të kryer mbikëqyrjen në kundërshtim me dispozitat e nenit 42 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1. të këtij ligji.

KAPITULLI VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 47

Nxjerrja e akteve nën-ligjore

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, nxirren në afat prej një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji .

Neni 48

Aktet nën-ligjore të zbatueshme deri në nxjerrjen e akteve të reja nën-ligjore

1. Me kusht që mos të jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nën-ligjore për zbatimin e duhur të këtij ligji, aktet nën-ligjore të zbatueshme do të vazhdojnë të mbesin në fuqi si në vijim:

1.1.Udhëzimi Administrativ nr. 11/2013 për përdorimin e njësive matëse;

1.2.Udhëzimi Administrativ nr. 03/2013 për etalonët shtetëror;

1.3.Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 06/2016 për llojin, formën dhe mënyrën e vendosjes së shenjave verifikuese të cilat përdoren në verifikimin e mjeteve matëse ligjore;

1.4.Rregullorja nr. 06/2013 për shenjën e konformitetit;

1.5.Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 02/2015 për periudhën verifikuese të mjeteve matëse ligjore, mënyra e zbatimit si dhe periudhat ri-kalibruese për etalonët të cilët përdoren për verifikimin e mjeteve matëse ligjore;

1.6.Udhëzimi Administrativ, nr. 01/2013, për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 08/2012 për lartësinë dhe mënyrën e pagesës për shërbimet në metrologji;

1.7.Rregullorja Administrative nr. 29/2012 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së MTI-së;

1.8.Udhëzimi Administrativ 15/2011/ (drafti i ri i Rregullores NAWI);

1.9.Rregullorja (MTI) nr. 06/2016 për mjetet matëse;

1.10.Udhëzimi Administrativ nr. 2011/16 (autorizimi i trupave për vlerësimin e konformitetit).

2. Inspektorati i tregut do të kryej mbikëqyrjen metrologjike/inspektuese deri në funksionalizimin e Sektorit për mbikëqyrje metrologjike në kuadër të AMK-së.

Neni 49 **Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohet, Ligji nr. 03/L-203 për Metrologji dhe Ligji nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për Metrologji.

Neni 50
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L -037
30 mars 2018

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI